



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 406/1 Prot.

Tiranë, më 06.03.2024

V E N D I M

Nr. 58, Datë 06.03.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 181, datë 25.09.2023, që i përket ankuesit Fondacioni “Së Bashku”, kundër Hotel Flower, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuar, lidhur me mosgarantimin e aksesueshmërisë në mjediset e hotelit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon se: *“Me datë 19.09.2023 kishim trajnim me personat me aftësi të kufizuara por rampa në hyrje të hotelit është jashtë standardeve të miratuara dhe e rrezikshme. U detyruam të futemi nga pas hotelit dhe aty e papërshtatshme dhe na u desh ndihma e disa personave që të mos dështonte trajnimi. Banaku i recepsionit ishte i lartë dhe nuk ka tualet të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara”*.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmirësimin e situatës dhe plotësimin e të gjitha standardeve për personat me aftësi të kufizuara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të

komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Bazuar në ankesën e paraqitur, Fondacioni “Së Bashku” pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara lidhur me mohimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), në mjediset e Hotel Flower, për shkak të papërshtatshmërisë së rampës, banakut të receptionit dhe mungesës së sinjalistikës për personat me vështirësi në shikim, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore të aktit normativ, VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””, nëpërmjet të cilave PAK janë përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Hotel Flower.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: “Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”

Bazuar në nenin 4, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare”.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezulton se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë

që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së Fondacionit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur.

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Fondacioni “Së Bashku”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, në kuadër të përfaqësimit të interesave të gjithë grupit të personave me AK, të cilët janë përftitues të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi “aftësia e kufizuar”, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato;

- a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...

- c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”*

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1033/1, datë 09.10.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Infomacion mbi përmbushjen e aspekteve që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi, të ndërtesës së Hotelit, shoqëruar me dokumentacion përkatës.
 - Cilat janë masat e ndërmarra nga ana juaj lidhur me sa më sipër, për zgjidhjen e kësaj problematike (*aksesueshmërisë nëpërmjet rampës dhe elementëve të tjera të aksesueshmërisë për personat me AK*)? Parashtrime dhe kopje të akteve provuese, nëse dispononi.
 - A është bërë nga ana e Hotel Flower një planifikim (afatshkurtët/afatmesëm) i fondeve të nevojshme për sigurimin/përmirësimin e aksesueshmërisë së Hotelit për personat me aftësi të kufizuara dhe afatet kohore për realizimin e këtyre investimeve? Nëse po, kopje të dokumentacionit ku janë bërë planifikimet përkatëse financiare dhe afatet kohore.
- Me shkresën nr. 1033/2, datë 06.11.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar përsëri subjektin për dhënien e informacionit të kërkuar me shkresën nr. 1033/1, datë 09.10.2023.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1033/3, datë 15.11.2023, Hotel Flower, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Hotel Flower ushtron aktivitetin e tij në fushën e hoteleri turizëm, dhe si e tillë zotëron ambiente akomoduese për të gjithë personat duke garantuar barazi dhe mosdiskriminim. Që në themelim, hoteli dhe njësitë akomoduese janë projektuar dhe përshtatur për tu ardhur në ndihmë dhe të mos ndihen të diskriminuar personat me aftësi të kufizuara duke krijuar rampa dhe ambient me lëvizshmëri të përshtatshme dhe të aksesueshme për të gjithë vizitorët e hotelit, ashtu si dhe ambiente tualeti të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Hotel Flower ka nisur aktivitetin e vet në Janar 2016 dhe gjatë gjithë kohës së aktivitetit të tij ka qenë i pajisur me rampa, dysheme të njëtrajtshme dhe pa pengesa, akses në çdo kat me ashensorë, tualet për persona me aftësi të kufizuara dhe dhoma të përshtatshme për turistë me aftësi të kufizuara.*

Pretendimi nga ana e ankuesit se nuk ka një rampë të përshtatshme për të hyrë në hotel është i pavërtetë pasi hoteli që prej krijimit ka pasur rampa të përshtatshme si në pjesën e hyrjes për në hotel ashtu dhe në pjesën e barit (përreth pishinës).

Aksesueshmëria me lehtësi në të gjithë ambientet e hotelit për personat me aftësi të kufizuara ka qenë prioritet që prej krijimit të hotelit, fakt ky i dokumentuar në faqen e Flower Hotel në BOOKING.COM dhe e verifikuar nga specialistët e BOOKING për ofrimin e paketave turistike.

Për sa më sipër, pretendimi se rampat janë të paaksesueshme është tërësisht i pavërtetë, po aq sa dhe i pavërtetë është fakti se për të hyrë në hotel është përdorur pjesa nga prapa hotelit. Pjesa hyrëse nga prapa hotelit është vetëm për personelin dhe një person me aftësi të kufizuara nuk mund të hyjë dot pasi është e destinuar vetëm për personelin dhe të çon te kuzhina (pjesa nga bëhet furnizimi i kuzhinës).

Personat me aftësi të kufizuara për të shkuar në barin dhe restorantin rreth pishinës u është mundësuar kalimi nga holli kryesor i hotelit në kushte mjaft të përshtatshme dhe komode kalimi ku dhe aty ndodhet rampë për të mundësuar akses të plotë të kësaj pjese të hotelit.

Në ankim është pretenduar se hoteli nuk ka tualete për personat me aftësi të kufizuara. Ky pretendim është i pavërtetë pasi siç po jua vërtetojmë nëpërmjet fotografive, hoteli disponon tualet dhe dhomë për persona me aftësi të kufizuara. Bashkëngjitur gjeni 3 (tre) foto të tualetit të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara ku doreza mbajtëse mban peshën deri në 150 kg, është e lehtë për tu përdorur dhe mund të kthehet në pozicion 90° për tu përdorur nga personat me aftësi të kufizuara.

Në ankim është pretenduar se banaku i recepsionit është i lartë. Ky pretendim është i pavërtetë pasi banaku i recepsionit është i përshtatshëm për të gjithë personat pa asnjë dallim apo diferencim, dhe aq më tepër që banaku është i hapur në anën e djathtë (pa banak) dhe recepsionistët kurdoherë i shërbejnë klientit menjëherë (pa barrierë) kur është nevoja për ndihmën e tyre dhe/apo duke i asistuar apo orientuar për gjërat që ata kanë nevojë”.

Në përgjigje të parashtrimeve të Hotel Flower, subjekti ankues me e-mail-in datë 15.11.2023, informon se: *“- Rampa në hyrje e dini sa përçind e ka pjerrësinë!? Mund të garantoj se është shumë përtej 5% që parashikon ligji, por edhe më shumë. - Po, është e vërtetë që ne hymë nga dera e stafit në pjesën e pasme të hotelit dhe mendoj se hoteli ka kamera për ta verifikuar këtë. - Fotot nuk mund t’i shoh por ne u futëm në tualet, nuk është i aksesueshëm duke filluar nga dera. - Sporteli është shumë i lartë, a mund të japë Hotel Flower lartësinë në centimetra? - Nuk ka elementë për personat me aftësi të kufizuara në shikim”*.

- Me shkresën nr. 1033/4, datë 16.11.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga subjekti, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - A i plotëson Hotel Flower, standardet teknike të rampës, mbështetësit të dorës, të tualetit, të sportelit/receptionit dhe të personave me vështirësi në shikim, sipas parashikimeve të VKM nr. 1503, datë 19.11.2008.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1033/5, datë 30.11.2023, Hotel Flower, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Duke qenë se hoteli është ndërtuar nga subjekti ndërtues që është i ndryshëm nga subjekti pronar, kërkesën për informacion ua kemi drejtuar shoqërisë ndërtimore për të na vendosur në dispozicion të dhënave teknike dhe për këtë kërkojmë shtyrje të afatit 10 ditor”*.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1033/6, datë 06.12.2023, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 19.12.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 19.12.2023 dhe morën pjesë, përfaqësuesi i Fondacionit *“Së Bashku”*, znj. S.L dhe përfaqësuesi me autorizim i Hotel Flower¹, avokat A.K.

Gjatë seancës dëgjimore, palët parashtruan dhe njëherë pretendimet e tyre të bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, duke identifikuar se pretendimet janë për mjediset e Hotel Flower 1 dhe jo për Hotel Flower Garden dhe u dakordësuan për përmirësimin e kushteve të aksesueshmërisë së mjediseve të Hotel Flower 1, për në periudhën në vijim.

- Me anë të shkresës nr. 284, datë 13.02.2024, Komisioneri iu drejtua sërish Hotel Flower dhe kërkoi informacion mbi veprimet e ndërmarra, lidhur me plotësimin e kushteve të aksesueshmërisë së mjediseve të hotelit.

¹ Referuar autorizimit datë 01.09.2023, të Shoqërisë *“Flower Hotel&SPA”* Shpk.

- Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nenit 39, të Rregullores së Brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”²*, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 23, datë 22.02.2024, të Komisionerit, në datën 05.03.2024, nga inspektorët e KMD-së, u realizua inspektimi në ambientet e Hotel Flower 1.

Objekti i inspektimit ishte marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, lidhur me parashikimet e bëra nga ana e Hotel Flower 1, për plotësimin e standardeve teknike të rampës, të tualetit, të sportelit/receptionit dhe të sinjalistikës për personat me vështirësi në shikim, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”.

Gjatë inspektimit, me Menaxherin e Përgjithshëm të Hotel Flower, z. E.Ç, nga inspektorët e KMD-së, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua fakti se, rampa në hyrje të hotelit ishte bërë e re, në hollin e hotelit ishte vënë një tavolinë e pajisur me kompjuter e cila do të shërbente si reception për personat me aftësi të kufizuara, në dysheme ishte vendosur sinjalistikë për personat me vështirësi në shikim dhe tualeti për personat PAK ishte në katin e dytë të hotelit, i cili ishte i aksesueshëm nëpërmjet ashensorit.

- Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, Fondacionit “Së Bashku”, i janë dërguar nëpërmjet e-mailit datë 05.03.2024, procesverbali i inspektimit dhe fotot e videot ilustruese, të bëra në mjediset e Hotel Flower 1.

Pasi është njohur me informacionin dhe fotot e videot e bëra gjatë inspektimit, përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku”, znj. S.L, nëpërmjet e-mailit të dërguar me datë 05.03.2024, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë Komisionerit, pasi ka vlerësuar masat e ndërmarra nga ana e Hotel Flower 1, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për zgjidhjen e situatës së aksesimit të personave me aftësi të kufizuara në mjediset e Hotel Flower 1.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për*

² <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a), nenin 33, pikat 9-10, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 181, datë 25.09.2023, të Fondacionit “Së Bashku”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA